

2003/641/KE: Vendim i Komisionit, datë 5 shtator 2003, për përdorimin e fotografive me ngjyra dhe ilustrimeve të tjera, si paralajmërim për shëndetin mbi paketimet e produkteve të duhanit (tekst kuptimi i të cilit lidhet me ZEE-në) (njoftuar me dokumentin numër C(2003) 3184)

Gazeta Zyrtare L 226, 10/09/2003 fq. 0024 - 0026

Vendim i Komisionit datë 5 shtator 2003, për përdorimin e fotografive me ngjyra dhe ilustrimeve të tjera, si paralajmërim për shëndetin mbi paketimet e produkteve të duhanit (njoftuar me dokumentin numër C(2003) 3184) (tekst kuptimi i të cilit lidhet me ZEE-në) (2003/641/KE)

KOMISIONI I KOMUNITETEVE EUROPIANE,

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit Europian,

Duke pasur parasysh Direktivën 2001/37/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 5 qershor 2001, mbi përafrimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të Shteteve Anëtare në lidhje me prodhimin, paraqitjen dhe shitjen e produkteve të duhanit [1], dhe veçanërisht nenin 5 pika 3 të tij,

Duke pasur parasysh se:

- (1) Direktiva 2001/37/KE përcakton që, përveç duhanit për përdorim oral dhe produkteve të tjera të duhanit jo për djegie, çdo paketë njësi e produkteve të duhanit dhe çdo ambalazh i jashtëm me përjashtim të mbështjellësve të tejdukshëm shtesë, duhet të kenë një paralajmërim të përgjithshëm dhe një paralajmërim shtesë të marrë nga lista e përcaktuar në Shtojcën I të asaj direktive.
- (2) Shtetet Anëtare mund të vendosin, nëse duhet ta bëjnë të detyrueshme vendosjen e paralajmërimëve për shëndetin në formën e fotografive me ngjyra apo ilustrimeve të tjera, në paketimet e disa apo të gjitha tipave të produkteve të duhanit, me përjashtim të duhanit për përdorim oral dhe produkteve të tjera të duhanit jo për djegie.
- (3) Kur Shtetet Anëtare parashikojnë paralajmërim shtesë në formën e fotografive me ngjyra apo ilustrimeve të tjera, këto duhet të jenë në përputhje me rregullat që miratohen nga Komisioni.
- (4) Direktiva 2001/37/KE ka prezantuar dispozita të reja në lidhje me etiketimin, të cilat ndryshojnë qenësisht aspektin e paketimeve të duhanit, veçanërisht në lidhje me përmasat e tekstit paralajmërues dhe paraqitjen e tij grafike. Për të përfituar nga efekti pamor i arritur nga kjo paraqitje e re grafike, është e pranueshme të lihet të kalojë një periudhë kohore e caktuar, pa bërë asnjë ndryshim, para se të vihen fotografitë me ngjyra apo ilustrime të tjera.
- (5) Siç është vërtetuar nga disa kërkime shkencore dhe nga përvoja e vendeve të tjera që kanë vënë fotografi me ngjyra në paralajmërimet për shëndetin, të cilat përfshijnë fotografi me ngjyra apo ilustrime të tjera, mund të rezultojnë si mjet efikas për të nxitur lënien e duhanpirjes dhe për informimin e qytetarëve në lidhje me rreziqet që duhanpirja i sjell shëndetit. Vënia e fotografive në paketimet e produkteve të duhanit përbën një element kyç të një politike globale dhe të integruar për luftën kundër duhanpirjes.

- (6) Duke pasur parasysh larminë kulturore që ekziston brenda Bashkimit Europian, duhet bërë e mundur që secilit paralajmërim shtesë të renditur në Shtojcën I të Direktivës 2001/37/KE t'iu korrespondojnë më shumë fotografi me ngjyra apo ilustrime të tjera.
- (7) Kur Shtetet Anëtare parashikojnë fotografi me ngjyra apo ilustrime të tjera si paralajmërim për shëndetin, duhet të sigurohet që këto elemente pamore të mos jenë të fshehura apo të ndryshuara në ndonjë mënyrë.
- (8) Kur Shtetet Anëtare parashikojnë fotografi me ngjyra apo ilustrime të tjera si paralajmërim për shëndetin, duhet të parashikohen periudha ndërmjetëse, me qëllim që të mundësohet kryerja e ndryshimeve të nevojshme në procesin e prodhimit, në procedurat e paketimit të produkteve të duhanit dhe heqjen e stokeve. Duhet të autorizohet vënia e etiketave të palëvizshme për produktet e duhanit, të ndryshme nga cigaret.
- (9) Vënia e paralajmërimeve të bazuara në pamje, duhet t'i nënshtrohet kontrolleve dhe efikasiteti të vlerësohet rregullisht.
- (10) Masat e parashikuara në këtë vendim janë në përputhje me opinionin e dhënë nga Komiteti i ngritur në bazë të nenit 10 të Direktivës 2001/37/KE,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1

Lënda dhe fusha e zbatimit

1. Ky vendim cakton rregulla për vendosjen e fotografive me ngjyra dhe ilustrimeve të tjera në paketimet e produkteve të duhanit, për të treguar dhe shpjeguar pasojat në shëndet nga duhanpirja.
2. Ky vendim zbatohet për ato Shtete Anëtare që vendosin të përdorin fotografi me ngjyra dhe ilustrime të tjera së bashku me paralajmërimet shtesë të përcaktuara nga Direktiva 2001/37/KE në paketimet e disa apo të gjitha tipave të produkteve të duhanit, me përjashtim të paketimeve të produkteve të duhanit për përdorim oral dhe të produkteve të tjera të duhanit jo për djegie.
3. Kur Shtetet Anëtare parashikojnë fotografi me ngjyra apo ilustrime të tjera si paralajmërim për shëndetin, ato duhet të jenë në përputhje me rregullat e përcaktuara nga ky vendim.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllimet e këtij vendimi, zbatohen përkufizimet e nenit 2 të Direktivës 2001/37/KE.

Zbatohen gjithashtu edhe përkufizimet e mëposhtme:

- 1) "paketim i produkteve të duhanit" nënkupton çdo formë pakete njësi dhe çfarëdo ambalazhi tjetër i jashtëm i përdorur në shitjen me pakicë të produkteve të duhanit, me përjashtim të mbështjellësve transparentë shtesë;
- 2) "paralajmërim shtesë" nënkupton çdo paralajmërim të përmendur në nenin 5 paragrafi 2, pika b) dhe në Shtojcën I të Direktivës 2001/37/KE;

- 3) "dokument i fillimit" nënkupton çdo dosje elektronike të ofruar nga Komisioni që përmban një paralajmërim të kombinuar;
- 4) "paralajmërim i kombinuar" nënkupton paralajmërimin që përbëhet nga fotografia ose një ilustrim tjetër si dhe teksti përkatës i paralajmërimeve shtesë të parashikuara nga neni 5 pika 2 shkronja b) dhe nga Shtojca I e Direktivës 2001/37/KE.

Neni 3

Biblioteka e dokumenteve bazë

1. Jo më vonë se data 30 shtator 2004, Komisioni krijon një bibliotekë me dokumente bazë që i janë nënshtruar paraprakisht provave, me qëllim që të vërë në dispozicion mundësi të bollshme zgjedhjeje mes fotografive apo ilustrimeve të tjera për secilin nga paralajmërimet shtesë të renditura në Shtojcën I të Direktivës 2001/37/KE.
2. Dokumentet bazë ofrohen nga Komisioni, me kërkesë. Të dhënat teknike për shtypjen përcaktohen nga Komisioni dhe nuk ndryshohen në asnjë mënyrë.
3. Në përgatitjen e bibliotekës së dokumenteve bazë, Komisioni mbështetet nga disa ekspertë shkencorë dhe teknikë.
4. Dokumentet e përzgjedhura të fillimit i nënshtrohen opinionit të Komitetit të krijuar ,në bazë të nenit 10 të Direktivës 2001/37/KE.

Neni 4

Përdorimi i paralajmërimeve të kombinuara

1. Kur Shtetet Anëtare parashikojnë fotografi me ngjyra apo ilustrime të tjera, si paralajmërim për shëndetin, çdo paketim i produkteve të duhanit për të cilin parashikohen këto fotografi, duhet të ketë detyrimisht një paralajmërim të kombinuar të marrë ekskluzivisht nga dokumentet e fillimit të ofruara nga Komisioni, pa ndryshuar asnjë nga përbërësit e tij.

Shtetet Anëtare mund të zgjedhin dokumentet bazë që janë më të përshtatshme për konsumatorët e vendeve të tyre.

2. Paralajmërimet e kombinuara:
 - (a) të alternohen në mënyrë të tillë, që të gjitha paralajmërimet shtesë të shfaqen rregullisht;
 - (b) të stampohen në sipërfaqen e dytë më të dukshme të paketimit të produkteve të duhanit, duke respektuar formatin dhe përmasat e dokumentit të fillimit , karakteristikat grafike të fotografisë dhe të tekstit;
 - (c) të zënë të gjithë sipërfaqen e rezervuar për paralajmërimin shtesë, në pozicionin paralel me brinjën e lartë të paketimit dhe në të njëjtin drejtim si informacionet e tjera që figurojnë mbi paketim;
 - (d) të riprodhohen në varësi të të dhënave teknike për shtypjen që përcaktohen nga Komisioni;
 - (e) të kenë kornizë me vizë të zezë, jo më i ngushtë se 3 mm dhe jo më i gjerë se 4 mm, që nuk ndërhyjnë në asnjë mënyrë në tekst apo në elemente të tjera pamore të paralajmërimit të kombinuar.
3. Paralajmërimi i kombinuar të mbulojë të paktën 40% të pjesës së jashtme të sipërfaqes së dytë më të dukshme të paketimit të produktit të duhanit. Kjo përqindje të rritet në 45% për Shtetet Anëtare me dy gjuhë zyrtare dhe në 50% për Shtetet Anëtare me tri gjuhë zyrtare.

Megjithatë, për paketimet njësi të menduara për produkte të ndryshme nga cigaret, pjesa më e dukshme e të cilave është më shumë se 75 cm², paralajmërimi i kombinuar të mbulojë të paktën 22.5 cm² të sipërfaqes së dytë më të dukshme. Kjo sipërfaqe të rritet në 24 cm² për Shtetet Anëtare me dy gjuhë zyrtare dhe në 26.25 cm² për Shtetet Anëtare me tri gjuhë zyrtare.

4. Për produktet e duhanit të ndryshme nga cigaret, paralajmërimet e kombinuara mund të vendosen nëpërmjet ngjitësve, me kusht që të jenë të palëvizshme. Riprodhimi i paralajmërimeve të kombinuara në ngjitëse, duhet të jetë në përputhje me të dhënat teknike për t'u shtypur, të përcaktuara nga Komisioni.

5. Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që paralajmërimet e kombinuara të shoqërohen nga një referencë, e vënë jashtë pjesës së kufizuar që përmban paralajmërimin për autoritetin lëshues. Për më tepër, nëse Shtetet Anëtare parashikojnë informimin e konsumatorëve për autoritetet që formulojnë paralajmërimet, dhe për programet ekzistuese në mbështetje të atyre që duan të lënë duhanpirjen, paralajmërimet e kombinuara mund të përfshijnë elemente të tjera pamore, si: markat me ose pa numra telefonikë, adresat postare elektronike dhe/ose faqet e internetit të menduara për këtë qëllim.

6. Përveç rasteve të parashikuara në paragrafin 5, paralajmërimet e kombinuara nuk komentohen, nuk perifrazohen dhe nuk përmenden në asnjë mënyrë në paketimin e produktit të duhanit.

Neni 5

Integriteti pamor i paralajmërimeve të kombinuara

1. Paralajmërimet e kombinuara:

- (a) të shtypen në mënyrë të palëvizshme, të pafshishme, dhe në asnjë mënyrë të fshehura apo të ndërprera nga tekste apo pamje të tjera, dhe as nga hapja e paketimit. Të ndalohet shtypja e paralajmërimeve të kombinuara mbi pullat tatimore apo mbi pullat e çmimeve të paketimeve njësi;
- (b) të tregohen në mënyrë të tillë, që të sigurojnë se asnjë nga elementet e tekstit apo të pamjes së paralajmërimeve të kombinuara, të mos prishen në momentin e hapjes së paketimit.

2. Nëse Shtetet Anëtare vendosin të parashikojnë vënien e paralajmërimeve të kombinuara në paketimet e produkteve të duhanit, ato miratojnë rregullat e nevojshme për të parandaluar përdorimin e çdo lloji mbështjellëseje, qeseje, veshjeje ose kutie, apo ndonjë mjeti tjetër që fshehin apo ndërpresin pjesërisht ose plotësisht paralajmërimet e kombinuara apo ndonjë prej elementeve të tyre.

3. Pullat tatimore dhe të çmimeve nuk vendosen në mënyrë të tillë, që të fshehin apo ndërpresin pjesërisht ose plotësisht paralajmërimet e kombinuara, apo ndonjë prej elementeve të tyre.

4. Referencat ose elemente të tjera të përmendura në nenin 4 paragrafi 5 nuk pengojnë apo vështirësojnë dukshmërinë e paralajmërimeve të kombinuara.

Neni 6

Zbatimi

Kur Shtetet Anëtare vendosin të parashikojnë vendosjen e paralajmërimeve të kombinuara në paketimet e produkteve të duhanit, ata miratojnë dhe botojnë dispozitat e nevojshme që garantojnë që janë në përputhje me këtë vendim.

Ato i zbatojnë këto dispozita përpara datës 1 tetor 2004.

Dispozita të tilla parashikojnë periudha të përshtatshme kalimtare, me qëllim që të mundësojnë kryerjen e ndryshimeve të nevojshme në procesin e prodhimit për procedurat e paketimit të produkteve të duhanit dhe në heqjen e stokeve, veçanërisht për sa i përket ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Me miratimin e këtyre dispozitave, Shtetet Anëtare i referohen këtij vendimi ose i shoqërojnë këto dispozita me një referencë të botimit të vendimit në Gazetë Zyrtare. Mënyrat për të bërë një referencë të tillë përcaktohen nga vetë Shtetet Anëtare.

Shtetet Anëtare i komunikojnë Komisionit dispozitat e të drejtës së brendshme që ato miratojnë në fushën që rregullon ky vendim, dhe informojnë Komisionin çdo dy vjet për ecurinë e zbatimit të tyre. Ky informacion duhet të përfshijë vlerësimin e ndikimit me një referencë të veçantë të sjelljeve të konsumatorëve, dhe në veçanti, duke i kushtuar vëmendje fëmijëve dhe të rinjve.

Neni 7 **Raportimi dhe përshtatjet**

1. Jo më vonë se 30 shtatori 2006, dhe pas kësaj në çdo dy vjet, Komisioni i paraqet Komitetit, të ngritur në bazë të nenit 10 të Direktivës 2001/37/KE, një raport për zbatimin e vendimit. Informacioni i marrë nga Shtetet Anëtare në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 6 të këtij vendimi, përbën bazën e raportimeve të tilla.
2. Në paraqitjen e raportit, Komisioni tregon, veçanërisht, elementet që duhen rishikuar apo zhvilluar në lidhje me përvojën e fituar, apo të njohurive të reja shkencore.
3. Ekspertët teknikë dhe shkencorë të përmendur në nenin 11 të Direktivës 2001/37/KE, mund të mbështetin Komisionin në përgatitjen e raporteve.
4. Informacioni mbi zbatimin e këtij vendimi përfshihet edhe në raportin dyvjeçar që Komisioni i paraqet Parlamentit Europian, Këshillit dhe Komitetit Europian Ekonomik dhe Social për zbatimin e Direktivës 2001/37/KE, në përputhje me nenin 11 të saj.

Neni 8 **Adresa**

Ky vendim u drejtohet Shteteve Anëtare.

Nënshkruar në Bruksel, më 5 shtator 2003.

Për Komisionin

David Byrne

Anëtar i Komisionit

[1] GZ L 194, 18.7.2001, fq. 26.